



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 215

Tiranë – E Mërkurë, 28 Janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 131, datë 24.12.2014	Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Axpo Albania” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... 12833
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 132, datë 24.12.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “ Anio Oil& Gas ” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror..... 12833
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 133, datë 24.12.2014	Për licencimin e shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 12834
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 24.12.2014	Për licencimin e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... 12834
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 24.12.2014	Mbi shqyrtimin dhe miratimin e “ <i>Energy Regulator’s Joint Opinion on Tap AG’S Request for a Prolongation of the Validity Period of the Exemption decision</i> ”/“Opinion i Përbashkët i rregullatorëve të energjisë mbi kërkesën e TAP AG për shtyrje të periudhës së vlefshmërisë të vendimit të përjashtimit”..... 12835
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 136, datë 26.12.2014	Për miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a. për vitin 2015..... 12838
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 26.12.2014	Për miratimin e planit të investimeve të OST sh.a. për vitin 2015..... 12842
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 26.12.2014	Për miratimin e planit të investimeve të OSHEE sh.a. për vitin 2015..... 12843
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 26.12.2014	Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015..... 12846
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 140, datë 26.12.2014	Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2015..... 12846
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 26.12.2014	Për përcaktimin e tarifës për shërbimet ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015..... 12846

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 26.12.2014	Për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për vitet 2013 dhe 2014.....	12847
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 144, datë 26.12.2014	Për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 dhe 2014.....	12847
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 145, datë 26.12.2014	Për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2015.....	12848
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 146, datë 26.12.2014	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 në nivelin e tensionit 35 kV.....	12848
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 147, datë 26.12.2014	Për përcaktimin e tarifës mesatare të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015.....	12849
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 148, datë 26.12.2014	Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015.....	12849
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 149, datë 29.12.2014	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. te shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a.....	12850
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 150, datë 29.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12850
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 151, datë 29.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	12851
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 152, datë 29.12.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji sh.a.”, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu”.....	12851
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 153, datë 29.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12852
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 154, datë 29.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	12853
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 155, datë 29.12.2014	Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.....	12853
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 156, datë 1.12.2014	Mbi miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (See Cao).....	12854
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 157, datë 29.12.2014	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. tek shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a.....	12854

**VENDIM****Nr. 131, datë 24.12.2014****PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SHA NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9, dhe nenit 45, pika 3, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., për rinovimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pikat 1, 2 dhe 3) është paraqitur dhe plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009 për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI**Petrit Ahmeti****VENDIM****Nr. 132, datë 24.12.2014****PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ANIO
OIL& GAS” SHA NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 14, pika 1, germa “ç”, si dhe neni 4, pika 1, germa “ç”; neni 8, neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “a” dhe nenin 10, të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Anio Oil & Gas sh.a.”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Anio Oil & Gas sh.a.”, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në nenin 9, pika 1 dhe pika 2 e rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe të rinovimit të licencave”, në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 133, datë 24.12.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LE TRADING ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”, 5, pika 2, dhe neneve 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pikat 1, 2 dhe 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Le Trading Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 134, datë 24.12.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “A&A GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGIJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “A&A Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “A&A Group” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht;



- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germa "a", "b", "c") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "A&A Group" sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, me një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 135, datë 24.12.2014

MBI SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E "ENERGY REGULATOR'S JOINT OPINION ON TAP AG'S REQUEST FOR A PROLONGATION OF THE VALIDITY PERIOD OF THE EXEMPTION DECISION"/"OPINIONI I PËRBASHKËT I RREGULLATORËVE TË ENERGJISË MBI KËRKESËN E TAP AG PËR SHTYRJE TË PERIU DHËS SË VLEFSHMËRISË SË VENDIMIT TË PËRJASHTIMIT"

Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2014,

Në zbatim të:

- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: Direktiva 73/09);

- Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009;

- Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në vijim rregullorja 715/09);

- Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar;

- Vendimit nr. 27, datë 1.3.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE, "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP –

AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline";

- Vendimit nr. 12, datë 14.2.2014 "Mbi shqyrtimin dhe miratimin e Programit të Përputhshmërisë e Rregullatore/*Regulatory Compliance Programme*' paraqitur nga TAP AG në bazë të 'Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion' në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP".

- Vendimit nr. 16, datë 13.3.2014 "Mbi miratimin e udhëzuesit për menaxhimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP për fazën e parë të rezervimit (*First Booking Phase*))", sipas 'Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion' në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP".

- Vendimit nr. 17, datë "Mbi shqyrtimin dhe miratimin e 'Njoftimit të fazës së rezervimit/*Booking Phase Notice*', paraqitur nga TAP AG për procedurën e alokimit të kapaciteteve të gazsjellësit TAP në përputhje me udhëzuesin e aprovuar me vendimin nr. 16, datë 13.3.2014.

- Kërkesës së TAP AG, për përjashtimin e gazsjellësit TAP, e datës 2 shtator 2011 (në vijim letra e datës 2 shtator 2011).

- Vendimit të Komisionit Europian C (2013) të datës 16 maj 2013, "*Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on third party access, tariff regulation and ownership unbundling laid down in Articles 9, 32, 41(6), 41(8) and 41(10) of Directive 2009/73/EC*" (në vijim vendimi i Komisionit Europian i 16 maj 2013);

- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) të datës 14 maj 2013;

- Vendimit nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE "Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 27 datë 1.3.2013 "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline", për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr.1/2013) dhe vendimit të Komisionit Europian (C(2013)2949" nëpërmjet miratimit të dokumentit "Opinion i Përbashkët Përfundimtar i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti



Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)"/ *"Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG's Exemption Application Autorita për l'Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and Regulatory Authority of Greece (Greece)"* në vijim Final Joint Opinion;

- Kërkesës së TAP AG datë 5 shkurt 2014 (prot. hyrës nr. 56/1 datë 8.2.2014), për miratimin e draftit final të "Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme" i dorëzuar më parë në 15 nëntor 2013 (nr. Protokollit hyrës 500/19). E njëjta kërkesë i është paraqitur njëkohësisht dhe në të njëjtën formë edhe Autoriteteve Rregullatore të Italisë (AEEG) dhe Greqisë (RAE)

- Vendimit nr. 127, datë 7.11.2013 "Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në "Opinionin e Përbashkët Përfundimtar /Final Joint Opinion" në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP";

- Kërkesës së TAP AG të datës 8 janar protokolluar prej ERE me nr. prot. 56, datë 14.1.2014;

- Letra përcjellëse nga shoqëria tregtare TAP AG nr. prot 329/25 datë 17.12.2014,

duke konsideruar që:

- Shoqëria TAP AG, në përputhje me ligjin nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", ka paraqitur në ERE kërkesën për përjashtim në lidhje me projektin e një interkonjeksi qe kalon nga Greqia, dhe Shqipëria për të vijuar në Itali (në vijim gazsjellësi TAP); si i tillë për efekt të përjashtimit është e nevojshme përfshirja edhe e autoriteteve rregullatore (në vijim Autoritetet) për Greqinë Enti Rregullator i Energjisë (në vijim RAE) dhe për Italinë Autoriteti për Energjinë Gazin dhe Ujërat (në vijim AEEG);

- Paragrafi 4.10.2 e *Final Joint Opinion*, parashikon, në koherencë me nenin 36 paragrafi 9 të direktivës 73/09, që vendimi për përjashtim të humbasë efektin e tij mbas 3 vitesh nga adoptimi i tij (6 qershor 2016) nëse mbas skadimit të këtij afati nuk ka nisur ndërtimi i infrastrukturës dhe 6 vjet mbas adoptimit të tij nuk është ende operativ, përveçse nëse Komisioni vendos se vonesa është për shkak të pengesave të mëdha që janë jashtë kontrollit të subjektit të cilit i është dhënë përjashtimi;

- Afatet kohore të parashikuara merrnin në konsideratë gjendjen e projektit në momentin e adoptimit të *Final Joint Opinion*, si dhe të vlerësimeve më të mira të mundshme në atë kohë, në përputhje me datën e parashikuar për vënien në punë të gazsjellësit të pritshëm, për të cilin as konsorciumi Shah Deniz (në vijim konsorciumi SD), dhe as TAP AG nuk kishin marrë ende vendimin final për investim;

- Pas marrjes së vendimit përfundimtar të investimit në projektin në fjalë (14 dhjetor 2013), konsorciumi SD i njoftoi TAP AG-së që dritarja e parë e parashikuar nga *Funnelling Mechanism* do të zgjasë nga 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2022;

- Për sa është thënë më sipër, TAP AG, me anë të letrës të datës 27 qershor 2014, i ka kërkuar zyrtarisht autoriteteve që të shtyjnë periudhën e vlefshmërisë së vendimit të përjashtimit dhe rrjedhimisht të vendosë përkatësisht datat e 1 janarit 2020 dhe 31 dhjetorit 2022, kohë brenda së cilës gazsjellësi duhet të jetë i ndërtuar dhe operacional.

- Më pas, në letrën e 17 dhjetorit 2014 TAP AG informoi autoritetet që në bazë të njoftimit të fundit të marrë nga SD Consortium (16 dhjetor), dritarja e dytë e parashikuar nga *funneling mechsism* për shpërndarjen e gazit do të zgjasë nga 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020;

- Termat e propozuar do të mundësojnë për të bashkërenduar datën e supozuar të hyrjes në funksionim të gazsjellësit me kontratat themelore të gazit duke parë që nga informacioni i dhënë nga konsorciumit SD nuk është e mundshme që dorëzimi i parë i gazit të bëhet para janarit 2020;

- Në mbështetje të kërkesës së saj për shtyrjen e afateve, TAP AG, me letrat e 14 mars 2014, 11 nëntor 2014, 26 nëntor 2014 dhe 17 dhjetor 2014, shpjegoi se:

- Angazhimet aktuale kontraktuale të konsorciumit SD nuk lejojnë të kryhet shpërndarja e gazit në Evropë përpara datës 1 janar 2020 ose përtej 31 dhjetor 2020;

- Këto mekanizma kontraktuale janë imponuar mbi TAP AG nga konsorciumi SD prandaj TAP AG nuk ka asnjë fuqi për të ndikuar vendimet në lidhje me datën e dorëzimit të gazit;

- Për më tepër, mospërputhja e periudhës së vlefshmërisë së vendimit të përjashtimit dhe kohëzgjatjes së kontratave të gazit (i cili është



definuar edhe nga *funnelling mechanism*) mund të çojnë TAP AG dhe transportuesit drejt një rreziku të konsiderueshëm financiar dhe tregtar, sepse një mospërputhje e tillë do të krijonte pasiguri mbi:

i) kapacitetin e disponueshëm për transportuesit në fund të periudhës së përjashtimit, duke rezultuar në pamundësinë e këtyre të fundit për të përmbushur detyrimet e për të blerë gaz siç është parashikuar me nënshkrimin e kontratave afatgjata; dhe

ii) mundësia e TAP AG për kthimin e investimit në gazsjellës brenda 25 viteve, supozim mbi të cilin aksionarët e TAP AG kanë bazuar vendimin e tyre për të investuar në projektin në fjalë;

- *Funnelling mechanism* është projektuar në mënyrë që të sigurojë fleksibilitetin e nevojshëm për të bashkërenduar datën e vënies në punë të gazsjellësit me investime të ndryshme të pranishme përgjatë gjithë projektit; kështu që asnjë investim nuk kryhet shume më herët ose shumë më vonë duke ngarkuar kështu barrën financiare apo rreziqe të panevojshme në kurriz të investitorëve.

- *Funnelling Mechanism* nuk i referohet datës së hyrjes në punë të tubacionit sipas parimit *sine die* por, në të kundërt, përcakton një afat kohor me të cilin gazi dërgohet për të përdoruesit (domethënë, jo më vonë se 31 dhjetor 2020 në bazë të informacionit më të fundit të marrë me shkresën e datës 17 dhjetor 2014);

- Së fundmi, bashkërendimi në mes të periudhës së vlefshmërisë së vendimit të përjashtimit dhe kohës së *funelling mechanism* do të mundësonte transportuesit për të siguruar kapacitetin hyrës në sistemin e transportit italian për gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratave bazë për furnizimin e gazit.

Duke konsideruar që:

- Në përputhje me dispozitat e nenit 36 të direktivës 73/09, kërkesa e TAP AG me objekt shtyrjen e periudhës e vlefshmërisë së vendimit të përjashtimit është e motivuar nga rrethanat që ishin të panjohura në kohën e miratimit të *Final Joint Opinion* dhe përtej kontrollit të drejtpërdrejtë të kompanisë aplikuese;

- Afatet e lidhura me investimet e ndryshme në të gjithë zinxhirin e furnizimit të projektit në fjalë kanë ndikuar në datën e hyrjes në funksionimin e tubacionit;

- Vendimi për të përdorur *funneling mechanism* për të përcaktuar datën e hyrjes në punë të gazsjellësit

në lidhje me dërgesat e para të gazit në Evropë duket të jetë i përshtatshëm për të lejuar koordinimin e nevojshëm në mes të investimeve të ndryshme të nevojshme për të ndërtuar infrastrukturën komplekse të tilla si projekti në fjalë;

- Nga ana tjetër, zgjedhja e një date të caktuar të mundshme (që ndër të tjera është identifikuar përpara realizimit të projektit), brenda të cilit gazsjellësi duhet të jetë funksional, duket më pak e përshtatshme në këtë rast, duke qenë se mungesa totale e fleksibilitetit mund të shkaktojë rreziqe më të mëdha financiare dhe joefikasitet në dëm të atyre që investojnë përgjatë gjithë projektit;

- Shtyrja e mundshme e kohëzgjatjes së periudhës së vendimit të përjashtimit, kërkuar nga TAP AG, nuk duhet të shkaktojë një vonesë të mëtejshme në funksionimin e gazsjellësit - duke qenë se prej informacionit të marrë, rezulton tashmë se janë marrë përsipër detyrime mes blerësve dhe transportuesve, kështu që nuk do të ketë më shumë arsye për të shtyrë datën për shpërndarjen e gazit;

- Duke marrë në konsideratë argumentet e mësipërme, e gjykojmë të arsyeshëm qëndrimin pozitiv për sa i përket kërkesës së TAP AG për zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së vendimit të përjashtimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë “*Energy Regulator’s Joint Opinion on TAP AG’s request for a prolongation of the validity period of the exemption decision*”/“Opinion i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi kërkesën e TAP AG për shtyrje të periudhës së vlefshmërisë së vendimit të përjashtimit”, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Njoftimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Autoriteteve Rregullatore të Energjisë të Italisë (AEEG) dhe Greqisë (RAE) dhe TAP AG, për marrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 136, datë 26.12.2014****PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE TË KESH SHA PËR
VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9, 24 dhe 64 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e investimeve të KESH sh.a. për vitin 2015 (bashkëlidhur këtij vendimi, plani i investimeve).
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



		Viti 2015				Qëllimi i Realizimit të Investimit			
Nr.	Emërtimi i Investimit	3M-I	3M-II	3M-III	3M-IV	Viti 2015	Rritje e efikasitetit të prodhimit	Rritja e sigurisë së veprave	Përmirësimi i kushteve të punës në HEC
HEC FIERZE	1 Mbrojtje e anes së majte të Bjeftit të Poshtëm përballë Tuneleve nr.3 dhe nr.4 nga ura e rymeshpejtuesit deri tek muri ekzistues tek Ura e Drinit				75,000	75,000		X	X
	2 Sistemitimi i sheshit tek magazines e re, kthimi i këtij sheshi në parking automjetesh të mbuluar					0			X
	3 Ndërtimi i rrethimit të teritorit të HEC-it dhe ndriçimi i tij		55,000			55,000		X	
	4 Rikonstruksion i jashtëm i godinës së HEC -it , murit tek shkarkuesat dhe ambienteve përreth.			12,000		12,000			X
	5 Ndërtim prita malore dhe punime mirembajtjeje tek perrenjet e Gropave etj. Evadim i materialeve të ngurta tek baseni sipër rymeshpejtuesit, sistemin i zonës nga rymeshpejtuesi tek ruga hyrëse në hidrcentral dhe ndërtimi i kanalit të ujrave kulluese. (Vazhdim)		20,000	50,000		70,000	X	X	
	6 Rruga serpentine përgjatë diges, ndriçim i saj, riparimi i veshjes së betonit në trupin e diges nga ana e bjeftit të sipërm dhe bjeftit të poshtëm			98,500		98,500		X	X
	7 Sistemitimi i mureve në territorin e godinës së HEC dhe asfaltimi i shesheve deri tek ruga për në dige. Rehabilitimi i shkarkuesit dhe kanalit të largimit të ujrave para transformatoreve të fuqisë. Sistemitimi i rugës nga rymeshpejtuesi deri tek hyrja e Galerisë së Diges, sheshi dhe rrethimi mbrojtës tek shkarkuesit e Transformatoreve të fuqisë.			33,000		33,000			X
	8 Rehabilitimi i sistemit të trajtimit të vajrave elektrik, mekanik dhe pajisja me dy filter-presa.		43,000			43,000	X		
	9 Hartimi i preventivit dhe rehabilitimi i zonave të demtuara nga fenomeni i kavtacionit tek tunelit nr.4 i shkarkimit	10,000	20,000	15,000	20,000	65,000		X	
	10 Studimi dhe modelimi i shkarkimeve të HEC për ndikimin e tyre në mbrojtjen të anës së majtë të bjeftit të poshtëm.	42,000				42,000	X	X	X
	11 Instalimi i piezometrave në shpatet e diges dhe furnizim-vendosjeje e 4 kapërderdhësve			5,000		5,000		X	X
	12 Furnizim Vendosjeje i portave hyrëse të galerisë dhe pastrimi i galerisë në kuotën 296		2,000			2,000		X	X
	13 Furnizim vendosjeje tub shkarkimi Ø 150-200 mm, të pompave nga galeria e cimentimit në kuotën 178.00 m deri në dalje të galerisë kuota 198.00 m.				1,000	1,000			X
	14 Kontrolli me metoda gjeofizike i filtrimeve totale në dige dhe shpatet e saj					0		X	
	15 Transferim i të dhënave të monitorimit gjeologjik dhe sizmik të diges online në KESH sh.a					0			
	16 Matjet gjeodezike dhe lidhja e sistemit gjeodezik të Digave të kaskadës së Drinit dhe masivit të Poravës me sistemin unik gjeodezik WGS84		5,000			5,000		X	
	17 Blerjeje Elektropompe për impijantin Hidraulik në Veprën e Marjes	25,000				25,000			
	18 Gjenerator saldimi për punime në roten e punës (I=700 A , U=3x380V)		2,000			2,000			X
	19 Studimi i fenomenit të rrjedhjes së materialit bituminoz tek agregati nr.2 dhe zëvendësimi i tij.		12,000			12,000		X	
	20 Pastrimi dhe lyerja e portave të remontit në veprën e marjes dhe në bjetin e poshtëm.					0		X	
	21 Pastrimi i zonës para rjetave (kuota 222m) dhe rjetave të punës tek seksionet e tubacionit të agregatit nr.4 me konsulence të huaj, për zëvendësimin e rjetave të punës, (niveli i ligenit duhet të jetë poshtë kuotes 270m).	5,000			35,000	40,000	X	X	
	22 Rehabilitimi i ndertesës së kullës së ekulibrit tek tuneli nr.3 i shkarkimit			6,000		6,000		X	X
	23 Ndërtim i kapërderdhësit tek kanali në veprën e marjes dhe mbrojtja nga reshqitja e kabines elektrike 10KV		3,600			3,600		X	
	24 Projektimi dhe instalimi i sistemit të ventilim-kondicionimit (HVAC) në sallën e makinave dhe turbinave në ndertesën e HEC Fierze.	4,000			86,000	90,000		X	X
	25 Rikonstruksioni i shkallëve nga ndertesë e centralit deri tek N/Stacioni 220 KV dhe i shkallëve nga ndertesë e centralit deri tek kurora e diges.		18,000			18,000		X	X
	26 Projekt zbatim për interierin e zyrave të reja, Blerjeje orëdi dhe pajisjeje për zyrat e reja	1,000	10,000			11,000			X
	27 Blerjeje autobusi të përshtatshëm për kushtet e zonës ku ndodhet HEC Fierze (alpin)					0			X
	28 Rehabilitim i agregatit nr. 1 - inxhinjeringu dhe modelimi, Prodhimi i rotes së punës. - Prodhim i statorit komplet(nukel +peshtjella). - Prodhimi i peshtjellave të poleve të rotorit.					0	X	X	
	29 Rehabilitim i agregatit nr. 3 - Prodhimi i rotes së punës. Modelimi dhe inxhinjeringu - Prodhim i statorit komplet(nukel +peshtjella). - Prodhimi i peshtjellave të poleve të rotorit.					0	X	X	
	30 Rehabilitim i gjeneratorit të ag-2 me prodhim të ri të statorit komplet(nukel +peshtjella) dhe me prodhim të ri të peshtjellave të poleve të rotorit.					0	X	X	
	31 Rehabilitim i gjeneratorit të ag-4- me prodhim të ri të statorit komplet(nukel +peshtjella) dhe me prodhim të ri të peshtjellave të poleve të rotorit.					0	X	X	
	32 Furnizim, vendosjeje pajisjeje laboratorike 1. Viskozimetrike gjysem automatik sipas ASTM 455, Komplet me aksesore 2. Analizator (portabel) i grimcave të ngurta dhe lageshhtësive për vajrat hidraulike me lazer. 3.Kape Aspirator kimik i mbyllur Komplet me aksesore 4. Kamera (potabel) infra të kuqe për monitorimin e temperaturave në gjeneratore dhe transformatore.		7,000			7,000		X	X
	33 Furnizim montim i shkallëve metalike tek portat e tunelit nr.4 të shkarkimit		19,200			19,200		X	X
	34 Zëvendësimi i transformatoreve të nevojave vetjake të agregateve, kater cope me fuqi 750 KVA			10,000		10,000	X	X	
	35 Furnizim vendosjeje motorgjenerator emergjence diesel, 0.4 KV, 1000 KVA, për nevojat vetjake të centralit.					0		X	
	36 Furnizim vnc me kapacitet 5T dhe instalim i tij në vncin Nr.2 të Salles së Makinave		3,200			3,200		X	
	37 Furnizim, transformator fuqie 150 MVA					0	X	X	
	38 Blerjeje paisjeje informatike për zyrat e reja, paisjeje për rjetin e brendshëm kompjuterik përfshirë sistemin e monitorimit me kamera.		9,000			9,000		X	
	39 Furnizim, vendosjeje 3 (tre) cope transformatore fuqie 320KVA, 10/0.4KV për nevojat vetjake në Veprën e Marjes dhe Tunelet e Shkarkimit					0	X	X	
	40 Rehabilitim i konstruksioneve metalike dhe lyerja e vncit me kapacitet 125/10 Ton në Veprën e Marjes		8,000			8,000		X	
	41 Rehabilitim i impiantit hidraulik në Veprën e Marjes					0	X	X	
	42 Instalim i sistemit të monitorimit on-line të shkarkimeve pjesore në 4 gjeneratoret e HEC Fierze					0		X	
	43 Instalim i sistemit të monitorimit on-line të hapsirës ajrore rotor-stator në 4 gjeneratoret e HEC Fierze					0		X	
	44 Furnizim vendosjeje vnc me kapacitet 5T dhe instalim i tij në vncin ure Nr.2 të Salles së Makinave	2,500				2,500			
	45 Furnizim vendosjeje Sistem i Ri Eksitimi Statik me Rregulator Automatik Dixhital Tensioni (Digital AVR), me dy kanale automatike redundant për Gjeneratorin Sinkron 3 fazor,147 MVA, 13, 8 KV, HEC Fierze	100,000				100,000			
	46 Pjesë rezerve për pajisjet elektrike dhe mekanike (planifikim për çdo vit)	40,000				40,000	X	X	
	47 Trajnim on-site të personelit inxhinjero - teknik dhe të Dep.Mirembajtjes për këto fusha specifike: - Rregulatori automatik i shpejtësisë së turbinës (DTL – kontraktori Andritz); - Rregulatori automatik i tensionit të gjeneratorit (ES202-C1F2NpP ABB Sadelmi Itali-kontraktori ALSTOM Itali; - Mbrojtjet elektrike të agregateve (ABB Sadelmi Itali)		15,000			15,000			
			229,500	252,000	229,500	217,000	928,000		



HEC KOMAN	1	Blerje minibuz i ri 25-30 vende cope 1 (nje)							0				X
	2	Rikonstruksioni i rrugeve prapa ndertesës se centralit							0				X
	3	Evadimi i nerteve tek fundi diges, shtrati lunt dhe betonimi i anes se djathte te daljes se tunelit nr.4 dhe ndertimi i diges mbrotjese (prites se perroit ne krahun e majte te rjetshes se lunt)				280,000			280,000		X		
	4	Punime mbrotjese te kanalit te daljes nga ndertesja centralit, veshje me beton i faqeve anesore							23,000		X		
	5	Rehabilitimi i vinct dhe gresjert te pasirmit te rjetave ne vepren e marjes							230,000		X		
	6	Pastrimi i zones ne kuoten 142 m dhe rjetave, tek tunelet e turbinave ne vepren e marjes nga materialet inerte dhe drusore	23,000						230,000		X		
	7	Reabilitimi i fasades se ndertesës se centralit							0		X		X
	8	Reabilitimi i ambienteve brenda ndertesës se centralit							0		X		X
	9	Punime per "Mbrotja e shpatules se djathte ne dige"							0		X		X
	10	Punime per asfaltimin e rrugeve tek serpentimat mbi kuoten 142m deni ne kuoten 185m							0		X		X
	11	Blerje automjet veteshkarkues 10 Ton, me pajise ngjites me kapacitet maksimal 5 ton	25,000						25,000		X		X
	12	Blerje mikrobuz 15+1 (2 cope)							0		X		X
	13	Rehabilitimi i shkallëve, tek portat e punes dhe remoniti tek tunelet e shkarkimit T3 + T4						50,000	50,000		X		X
	14	Implant i paretive te ndajave veshje per cdo te ekuat							0	X	X		X
	15	Blerje dhe montim - Transformator fuqie 170 MVA, 1 cope							0	X	X		X
	16	Riparimi me zevendesim peshjtelle te nje faze i Transformatorit te fuqise 170 MVA						50,000	50,000		X		X
	17	Rehabilitimi i cetesave 220 Kv te 4 blloqeve gjenerator - transformator tek neristacioni							0	X	X		X
	18	Cetesat 6 Kw me gaz per implantin 6 Kw tek implanti 13 LGA							0	X	X		X
	19	Reabilitimi i ndricimit te hidrocentralit							0		X		X
	20	Reabilitimi i ambienteve te brendshme te administrates Kati 1 + Kati 2							0		X		X
	21	Mobilimi i ambienteve te brendshme te administrates Kati 1 + Kati 2							0				X
	22	Blerje minibuz i ri 25 - 30 Vende cope 1 (nje)							0				X
	23	Monitorim me sistem kamerash i ambienteve te centralit dhe vepres se marjes							0		X		X
	24	Pajise dhe pjesë rezerve per mirembajtje ne central	50,000						50,000		X		X
	25	Furnizim, vendosje pajise laboratorike 1. Viskozimeter gjysem automatik sipas ASTM 455, Komplet me aksesore. 2.Kape Aspirator kimik i mbyllur Komplet me aksesore 3. Kamera (potabël) infra te kuqe per monitorimin e temperaturave ne gjeneratore dhe transformatore.	5,500						5,500		X		X
	26	Blerje ure matese dyfishte portative digjale per matje rezistence omike ne transformator				5,000			5,000		X		X
	27	Monitorim audio- video i stacionit te pompimit dhe transferimi i sinjalizimeve te panelit te kontrollit ne godinen e sherbimit ne kuoren e diges, perfishine ndertimin e sale.	5,000						5,000		X		X
	28	Rikonstruksion i rrethimit te hidrocentralit							25,000		X		X
Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015, do të jetë 1.45 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**

VENDIM**Nr. 140, datë 26.12.2014****PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 78, datë 26.6.2008,

“Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Tarifa e energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2015 do të jetë 3.0 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**

VENDIM**Nr. 141, datë 26.12.2014****PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR
SHËRBIMET NDIHMËSE TË KESH SHA
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.2 të Modeli i Tregut, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 i ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”; nenit 2.8 pika “iii” e “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për shërbimet ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015 dhe relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve,



VENDOSI:

1. Tarifa për shërbimet ndihmëse për vitin 2015 e KESH sh.a. do të jetë:

- 158 lekë /MWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 143, datë 26.12.2014

**PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT UNIK TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR TË LICENCUARIT PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET
EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR
DERI NË 15 MW, PËR VITET 2013 DHE
2014**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 26.1.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për vitet 2013 e 2014,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar

deri në 15 MW për vitet 2013 e 2014, do të jetë 7.53 lekë/kWh.

2. KESH sh.a. dhe çdo i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, të akomodojnë efektet financiare të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe te KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 144, datë 26.12.2014

**PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT UNIK TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR TË LICENCUARIT PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET
E RINJ ME FUQI TË INSTALUAR DERI
NË 15 MW PËR VITET 2013 DHE 2014**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.1.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 24, datë 11.4.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për vitet 2013 dhe 2014,



VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 e 2014, do të jetë respektivisht 9.73 lekë/kWh dhe 7.95 lekë/kWh.

2. KESH sh.a. dhe çdo i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, të akomodojnë efektet financiare të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 145, datë 26.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR VITIN
2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 59, datë 29.12.2005, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve;

VENDOSI:

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2015, do të jetë 0.65 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 146, datë 26.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN
2015 NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 79, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për vitin 2015 do të jetë:

- 1.5 lekë/kwh për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV.

Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 147, datë 26.12.2014**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS
MESATARE TË SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 79, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për vitin 2015 do të jetë:

- 4.79 lekë/kwh për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**

VENDIM**Nr. 148, datë 26.12.2014**

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË
SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT
TARIFORË PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve

të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 80, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**

Tarifat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015

<i>Niveli i tensionit</i>	<i>Cmimi (leke/kWh)</i>	<i>Cmimi pik (leke/kWh)</i>
Konsumatore ne 35 k V	9.5	10.93
Konsumatore ne 20/10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli ne 20/10/6 kV	7.1	8.17
Konsumatore ne 0,4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli ne 0,4 kV	7.6	8.74
Familjare	9.5	
Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (ndricim shkalle, pompe,ashensor)	9.5	
Tarife fikse e shërbimit per leximin "zero" (leke/muaj)		200

**Cmimi i energjise reaktive eshte sa 15 % e cmimit te energjise aktive*

**Orari pik gjate te cilit do te aplikohet tarifa per energjine e konsumuar ne pik eshte :*

Per periudhen 1 Nentor - 31 Mars nga ora 18:00 deri ne 22:00

Per periudhen 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri 23 : 00

**VENDIM****Nr. 149, datë 29.12.2014****MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “UJËSJELLËS
KANALIZIME TIRANË” SHA PËR
TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA
“UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË”
SHA TEK SHOQËRIA “HEC
LANABREGAS” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 17, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a., licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 134, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a., në cilësinë e shoqërisë që kërkon të transferojë licencën, ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e nevojshëm për të kryer këtë procedurë referuar rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- “Hec Lanabregas” sh.a., që kërkon të marrë licencën “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. e ka paraqitur dokumentacionin e në bazë të nenit 9 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a., shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së

Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a., dhe “Hec Lanabregas” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM**Nr 150, datë 29.12.2014****PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“ALBANIAN ENERGY SUPPLIER”
SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 2; 8, 10/3; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.



Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht. Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Neni 9, pika 4/10. Germa “a”, germa “b”, germa “c” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 151, datë 29.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9; 45 pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”; 5 pika 1 germa “f” 8; 10, pika 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike

dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/9. Germa “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar korrekt.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 152, datë 29.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI SHA” NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “GOJAN”, “GJEGJAN”, “PESHQESH” DHE “FANGU”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”,



dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen AS Energji sh.a.” plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5 janë plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ayen AS Energji” sh.a., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: “Gojan” me fuqi të instaluar 12,25 MW, “Gjegjan” me fuqi të instaluar 6,55 MW, “Peshqesh” me fuqi të instaluar 27,94 MW dhe “Fangu” me fuqi të instaluar 63,8 MW

(Me fuqi totale 110.54 MW).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr 153, datë 29.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “DEVOLL HIDROPOWER” SHA, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 2; 8, 10/3; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hidropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/10. Germa “a”, germa “b”, germa “c” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 154, datë 29.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “DEVOLL HIDROPOWER” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9; 45 pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”; 5 pika 1 germa “P” 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hidropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik,

administrator dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/9. Germa “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar korrekt.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a. për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr 155, datë 29.12.2014

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 43, datë 13.5.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE, ndryshohet si më poshtë.

Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do të shtrijë efektet deri në datën 31.3.2015.



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 156, datë 1.12.2014

**MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
ANKANDIT TË ZYRËS SË
KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR
EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO)**

Mbështetur në nenin 8, pika 2 dhe 9 e ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe neni 25 i Rregullave dhe Procedurave të ERE-s, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratim e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO) si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike,

konstatoi se:

Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian. Për miratimin e kësaj rregulloreje është marrë opinioni i të gjitha grupeve të interesit duke njoftuar zyrtarisht e publikisht ata. Në cilësinë e vendit anëtar të ECRB-s rekomandohet që rregullatorët kombëtarë anëtarë të saj, ta miratojnë këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO) bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 140, datë 22.11.2013 i Bordit “Për miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi në 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 157, datë 29.12.2014

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “UJËSJELLËS
KANALIZIME TIRANË” SHA PËR
TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA
“UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË”
SHA TEK SHOQËRIA “HEC
LANABREGAS” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20, pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 17, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a., licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 137, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. në cilësinë e shoqërisë që kërkon të transferojë licencën, ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e nevojshëm për të kryer këtë procedurë referuar rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- “Hec Lanabregas” sh.a., që kërkon të marrë licencën “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. e ka paraqitur dokumentacionin e në bazë të nenit 9 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a., shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a., dhe “Hec Lanabregas” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006